

DRTK SHKODËR

MIRATOHET

Sekretari i K. K. T. K. M

Ark. Klesta Qirici

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti: Projekt restaurimi dhe mirëmbajtje “Kisha Trikonëshe në kalanë e Drishtit”, Shkodër.

1- Gërmim e transport dheu me karro dore deri në 20 m (R 1)

Gërmimi që do realizohet do jetë një gërmim sipërfaqësor, duke përdorur vegla që nuk dëmtojnë muret perimetrale të kishës. Veglat që do përdoren do jene vegla krahu si kazëm ose lopatë. Nuk lejohet pastrimi dhe gërmimi me mjete të motorizuara. Përsa i perket transportit, materiali i gërmuar do largohet larg objektit në distancë minimale 100 m nga pika më e afërt e monumenit.

Transporti gjithashtu do të realizohet me vegla pune jo të motorizuara pasi dhe terreni nuk lejon përdorimin e mjeteve të tjera.

2- Pastrim nga bimësia e ulët (R5)

Në afërsi të mureve të kishës siç janë shënuar edhe në fletët teknike ka prezencë të bimësisë së ulët. Bimësia e ulët përfshin barërat, shkurret dhe bimë me diametër të vogël. Pastrimi i tyre do të bëhet në mënyrë mekanike. Të gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do të grumbullohen dhe do të largohen nga objekti.

3- Pastrim nga bimësia e ulët + injektim i solucionit për tharjen e bimeve të keqija (R 5/1)

Ky çmim përfshin pastrimin e muraturës nga bimësia e ulët si dhe injektimin e herbicideve për tharjen e bimësisë në pjesën e poshtme të muraturës si dhe bimësitë e shënuara në fasada. Procesi i punës përfshin prerje në mënyrë mekanike të vegjetacionit dhe rrënjëve, pastrimin e tyre në brendësi të muraturës deri aty ku është e mundur dhe tharjen e rrënjëve të cilat janë shumë të vështira për tu hequr mekanikisht me injektim. Injektimi do të realizohet nëse trungu/kërcelli ka diametër më të madh se 4 cm, ku pas prerjes do të bëhet injektimi i herbicidit tek rrënja.

4- Prerje dhe tharje të rrënjëve masive (raundap 200cc) (R. 5/2)

Nisur nga gjendja ekzistuese është parë se në vend ka pemë me lartësi deri 3 m të cilat që janë afër strukturës së mureve të monumentit. Rrënjët e këtyre pemëve mund të shkaktojnë probleme tek struktura e mureve. Pastrimi i tyre do të bëhet në mënyrë mekanike. Të gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do të grumbullohen dhe do të largohen nga objekti.

5- Pastrim nga bimësia e ulët muri në lartësi (R. 5/3)

Muret ekzistuese të kishës arrijnë një lartësi deri në 2 m tek të cilat kanë mbirë bimë të ndryshme të vogla, me kërcell të shkurtër dhe rrënjë të vogla. Pastrimi i tyre do të bëhet në mënyrë mekanike. Të gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do të grumbullohen dhe pastaj do të largohen nga objekti.

6- Konsolidim i kreut të murit me 1-2 rreshta gurë me llaç gëlqere 1:3 (R. 21)

Ky ze zhvillohet në të gjithë gjatësitë e kreut të mureve që nuk ka vazhdueshmëri të rregullt strukturore dhe vizuale. Aty ku llaci ka degraduar dhe ka pesuar shembje të elementeve strukturore. Pasi është bërë prishja e mureve të demtuar dhe pastrimi mekanik nga llacrat e demtuara kalohet në studimin e zonës lokale ku do konsolidohet. Behet përgatitja e elementeve mbushës në rastin tonë gurë të perzgjedhur në zonë rreth e rrotull murit të demtuar dhe përgatitja e llaçit sipas kerkese me raport 1:3 me konsistencë të ulët. Laget zona me ujë që të kemi lidhje sa më të mirë, inplemtohet llaci dhe guret duke ruajtur harmoninë dhe vazhdueshmërinë e murit për të rikrijuar kreun e tij.

Konsolidimi do realizohet me 1 ose 2 rreshta guresh dhe jo me shumë. Arsyeja kryesore është ndalimi i degradimit të murit dhe jo rimekembja e tij gjë e cila është e pamundur në mungesë të informacionit të pozicionimit dhe prezencës së elementeve të tij.

7- Fugatim muri (pastrim mekanik + larje me ujë + fugatime injektim materiali (R. 25)

Pasi është përcaktuar se ku do kryhet procesi i fugatimit merren masat për sigurimin e zonës përreth saj. Skeleritë do të ngrihen dhe do të instalohen sipas kushteve teknike të zbatimit. Pas instalimit të skelerive do të bëhet pastrimi mekanik me fuqë ose vegla të forta në zonat e përcaktuara në projekt dhe në rast zonash në nevojë, do të bëhet pastrimi i tyre. Faza tjetër e fugatimit është ajo e largimit të pluhurave të tepërt. Largimi i tyre do të bëhet me fuqë dhe fshesa. Në rast se pastrimet mekanike janë të thella të përdoret kompresor ajri për pastrimin e pluhurave. Pasi është bërë pastrimi mekanik dhe larja me ujë e hapsirës qëdo fugatohet bëhet përgatitja e llaçit mbushës të gëlqerës në raportin 1:3. Mbushja duhet të bëhet e plotë dhe duhet të ruhet njëtrajtshmëria e mbushjes në të gjithë zonën e përcaktuar sipas projektit.

8- Restaurim mur guri në lartësi deri 3 m (R. 9/1)

Ky zë pune kryesisht shoqërohet me çmontimin e fragmenteve të gurëve që janë në rrezik rënie, gjithmonë duke iu referuar fletëve teknike. Restaurimi i murit do të bëhet në të gjitha zonat ku muri ka pësuar shëmbie lokale, dhe ku janë shënuar mungesat që do të plotësohen. Në keto zona do behët përgatitja e elementeve gurë dhe llaç. Fillimisht do të përdoren guret që kanë rënë në afërsi të zonave ku do realizohet ndërhyrja. Në rast mungesash, gurët do të merren në zonën më të afërt për të ruajtur të njëjtin konfigurim. Pas sigurimit të elementiv mbushës dhe përgatitjes së elementit lidhës, hapi tjetër i punës është pastrimi nga llaçi i degraduar dhe gurët e levizshëm. Pas kryerjes së këtij procesi duhen të largohen pluhurat nga muratura në mënyrë që të bëhet lagia me ujë e zonës që të krijojë një bazë të mirë mbeshtetëse.

9- Restaurim i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit (Pastrim i çarjes, larje ne ujë, injektim llaç gëlqere 1:3) (R. 26)

Ne zonat e degraduara ku kemi prezence të çarjeve do behet restaurimi i tyre nepermjet teknikes se injektimit. Pasi behet evidentimi i sakte i zonave qe do te nderyhet fillohet me procesin e pastrimit te carjes. Carje fillimisht shikohet ne menyre te detajuar per prezencen e bimesive apo shkaku kryesor i krijimit te saj. Pasi eshte bere e qarte shkaku merren masat e mundura per ndalimin e ndikimit te metejsheem te tij. Pastrimi i carjes do filloje dhe te do behet ne gjithe gjatesine dhe thellesin e carjes. Pas largimit te materialit te demtuar dhe pluhrave prezente behet larja me uje deri sa zona te pastrohet plotesish. Hapi i fundit eshte injektimi i llacit te gelqeres i cili do te jete me raport 1:3.

10- Transport materiale me kafshë deri 1 km (R. 127)

Ky zë përfshin transportin e materialeve dhe paisjeve të punës të nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Shkak i përdorimit të këtij zëri është vështirësia e terrenit dhe largësia e objektit ku do të ndërhyhet nga rruga automobilistike.

Punoi: Fatjon Mlloja

Sabrina Kuçi

Elson Laqja

Jozel Radovani

Miratoi:

Besara Podgorica

Drejtor i DRTK Shkodër